



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo  
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës  
Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture  
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Kancelarij Generalnog Sekretara / Office of the General Secretary

<b>DATË/A:</b>	17.01.2025
<b>REFERENC-Ë:</b>	24/3666/MMPHI
<b>PËR/ZA/TO:</b>	"LUANTINI BETON " Sh.p.k., Sllatinë e Madhe, F.Kosovë. Impianti për prodhimin e betonit, Harilaq, Fushë Kosovë.
<b>CC:</b>	Komisioni për Leje Mjedisore
<b>PËRMES/PREKO/THROUGH:</b>	
<b>NGA/OD/FROM:</b>	Izedin Bytyqi, U.D. i Sekretarit të Përgjithshëm i MMPHI
<b>TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:</b>	Vendim për ndërprerje të procedurës administrative

Të nderuar/a,

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës (MMPHI), ka shqyrtuar kërkesën për vazhdim të Lejes Mjedisore të operatorit, "LUANITI BETON", Sh.p.k., Sllatinë e Madhe, F.Kosovë, për veprimtarinë: Impianti për prodhimin e betonit, Harilaq, Fushë Kosovë.

MMPHI, pas shqyrtimit të kërkesës të lartpërmendur, një sërë takimesh dhe vizitës në teren, ka vendosur si në Vendimin e bashkëngjitur:

Me respekt!





Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo  
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës  
Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture  
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Kancelarij Generalnog Sekretara / Office of the General Secretary

Nr.: 24/3666/MMPHI  
Datë: 20.01.2024

Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, në mbështetje të nenit 18 të Ligjit Nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funkcionimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura, (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 7/01 Mars 2019), Rregullores (QRK) Nr. 14/2023 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, nenit 31 të Ligjit Nr. 03/L-025 për Mbrojtjen e Mjedisit, paragrafi 3 të nenit 10 të Udhëzimit Administrativ MMPHI Nr. 04/2022 për Leje Mjedisore, nxjerr këtë:

## V E N D I M

Operatorit, "LUANTINI BETON" Sh.p.k., Sllatinë e Madhe, Fushë Kosovë me nr. prot. 24/3666/MMPHI, i ndërpritet procedura administrative për vazhdimin e Lejes Mjedisore, për veprimtarinë: Bazë për prodhimin e betonit në ngastrën, nr. P- 72514003-00292-3 dhe nr. P- 72514003-00294-0, zona kadastrale Sllatinë e Madhe, Fushë Kosovë.

## A r s y e t i m

Pas pranimit të kërkesës për Leje Mjedisore për operatorin "LUANTINI BETON" Sh.p.k., Sllatinë e Madhe, F.Kosovë, me nr. prot. 24/3666/MMPHI, për veprimtarinë: Bazë për prodhimin e, në ngastrën, nr. P- 72514003-00292-3 dhe nr. P- 72514003-00294-0, zona kadastrale Sllatinë e Madhe, Fushë Kosovë, MMPHI konstaton që operatori nuk ka plotësuar kushtet administrative për vazhdim të Lejes Mjedisore.





Kërkesës për tu pajisur me Leje Mjedisore i ka bashkangjitur dokumentacionin si në vijim:

- Aplikacionin e plotësuar në pesë kopje fizike dhe një kopje elektronike (CD);
- Fletëpagesën, në bazë të Vendimit: Nr. 13/99, te dt. 30.09.2022, për përcaktimin e kriterëve dhe vlerat e tarifës për shërbimet lidhur me procedurat e shqyrtimit të kërkesave për leje mjedisore;
- Certifikatën e regjistrimit të biznesit;
- Leje Mjedisore me nr. 19/1593/ZSP/400/19, data lëshimit: 01.08.20219;
- Leje Ujore për shfrytëzimin e ujit, me nr. 2439-2/19-ZSP-2021, datë e lëshimit: 13.11.2021
- Leje Ujore për shkarkimin e ujit, me nr. 2439-2/19-ZSP-2021, datë e lëshimit: 30.11.2021.

MMPHI, ka kontrolluar dokumentacionin dhe në përputhje me nenin 10 paragrafi 3 të Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 04/2022, ka kërkuar nga operatori plotësim të dokumenteve si në vijim:

- Lejen për aktivitete të veçanta nga KPMM, të afatizuar.

Operatori nuk ka sjell dëshmi për plotësimin e dokumentacionit të cekur me lartë.

Andaj bazuar në të cekurat më lartë, Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, mbyll procedurën administrative në përputhje me nenin 10 paragrafi 3 të Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 04/2022.

**Shpjegim për palën:** Dispozitivi i përcaktuar në vendim nuk sanksionon të drejtën e palës për ri aplikim sipas procedurës së rregullt.

Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.



**Këshilla Juridike:** Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të inicioj konflikt administrativ me padi, në Gjykatën Themelore, në afat prej 30 ditësh, nga dita e pranimit të këtij vendimi.

Izedin Bytyqi

U.D. i Sekretarit të Përgjithshëm i MMPHI-së



Vendimi iu dërgohet:

- Parashtruesit të kërkesës;
- Zyrës së Sekretarit të Përgjithshëm;
- Komunës- Fushë Kosovë;
- DMMU-së;
- Inspektoratit;
- Kabinetit të Ministrit
- Zyrës për komunikim me Publik të MMPHI-së;
- Arkivit të MMPHI-së.